

V E N D I M
Nr. 504, datë 16.10.2002

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 78, DATË 21.1.1999 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE "PËR RUAJTJEN E PRONËSISË SHTETËRORE NË DISA SHOQËRI
TREGTARE DHE NDËRMARRJE", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7 të ligjit nr. 8334, datë 23.4.1998 "Për privatizimin e shoqërive tregtare, që veprojnë në sektorët jostrategjikë", me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin nr. 78, datë 21.1.1999 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, në listën e pikës 1 që i bashkëlidhet vendimit, emërtesa "Petrolimpeks", sh.a. Tiranë, në të cilën ruhet pronësia shtetërore në kapitalin prej 51 për qind të aksioneve, shfuqizohet.

2. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë dhe Ministria e Industrisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano